


Përmbajtja:




PRODHIMI VENDOR I ENERGISË T'Ë MBULOJË NEVOJAT E KOSOVËS



VENDET E RAJONIT RRISIN NUMRIN E TERMOCENTRALEVE



PARASHIKIMI I PËRDORIMIT TË THËNGJILLIT NË KOSOVË



TERMOCENTRALI RI ME STANDARDET MË TË REJA TË BASHKIMIT EVROPIAN

PRODHIMI VENDOR I ENERGISË T'Ë MBULOJË NEVOJAT E KOSOVËS

Kërkesa për energji elektrike në Kosovë rritet nga viti në vit. Momentalisht, prodhimi vendor në Kosovë e ka të pamundur ta mbulojë kërkesën për energji elektrike, e kjo është problematike veçanërisht gjatë dimrit, kur edhe kërkesa është më e madhe dhe ndërprerjet janë bërë të zakonshme. Çmimi i jostabil dhe shumë i shtrenjtë, është barrë për të gjithë konsumatorët, e në të njëjtën kohë ndikon në pamundësinë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Prandaj, Kosova ka nevojë për të investuar në infrastrukturë të energjisë dhe në shtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.

Në vitin 2017, kërkesa për energji elektrike në Kosovë është mbuluar nga këto burime: 43% nga "Kosova B", 32% nga "Kosova A" dhe 3% nga burimet e ripërtëritshme (BRE). Kurse, pjesa tjetër, apo 22%, është importuar, e cila ka arritur vlerën rreth 70 milion Euro.

Strategjia e Energjisë së Kosovës në vitin 2023 parasheh një transformim të burimeve gjeneruese të energjisë elektrike në vend. Sipas kësaj, në këtë vit parashihet dekomisionimi i Termocentralit "Kosova A", si dhe rehabilitimi i Termocentralit

Kosova B. Gjithashtu, parashihet edhe rritja e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë deri në 23% të kërkesës vendore. Me të gjitha këto, ende mbi 37% e nevojave vendore për furnizim me energji elektrike mbetet e pambuluar, për çka është jetik finalizimi i Termocentralit "Kosova e Re", i cili do ta mbulojë këtë boshllëk, duke e bërë vendin të pavarur dhe duke eliminuar kështu nevojën e importit për ta arritur sigurinë e furnizimit me energji elektrike.


Termocentrali "Kosova e Re" do të luajë rol të rëndësishëm për të ardhmen e sektorit të energjisë, duke ofruar sigurinë e furnizimit me energji elektrike, duke eliminuar nevojën e importit, si dhe duke garantuar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm për qytetarët e vendit, pasi që me teknologjinë më të fundit në dispozicion do t'i përmbushë dhe respektojë Direktivat më të fundit të Bashkimit Evropian për emetime.

Termocentrali "Kosova e Re" është jetik për vendin, sepse siguron pavarësinë energjetike, perspektivën ekonomike dhe zhvillimin e gjithmbarshëm të Kosovës.

Burimi i Energjisë



RAJONI RRITË NUMRIN E TERMOCENTRALEVE ME THËNGJILL



Burimi: coalmap.eu

■ Termocentralet e planifikuara me thëngjill
 ■ Numri total i termocentraleve të planifikuara me thëngjill

Thëngjilli vazhdon të jetë shumë i pranishëm në tregjet dhe ekonominë evropiane. Edhe pse Bashkimi Evropian ka shënjestruar vitin 2050 për dekarbonizim, konvertimi i tërësishëm në burime të ripërtëritshme të energjisë (BRE) nuk është i mundur në të ardhmen e afërt.

Termocentralet me thëngjill vazhdojnë të ofrojnë stabilitet dhe siguri të furnizimit edhe në vendet e rajonit. Njësitë ekzistuese dhe termocentralet e planifikuara vazhdojnë të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe të mundësojnë siguri të furnizimit për vendet e rajonit, por dhe ato të Bashkimit Evropian.

Andaj, duke marrë për bazë gjendjen aktuale të furnizimit në vend, rajon dhe Evropë, si dhe nevojat për kapacitete shtesë të gjenerimit të energjisë elektrike, e bën kërkesë të patejkalueshme për vendin, ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re” si nevojë të menjëhershme

për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me energji për konsumatorin kosovar.

Si ilustrim po japim këtu planifikimet për ndërtimin e termocentraleve të reja me thëngjill në rajon, duke përfshirë edhe Kosovën:

- Kosova – 1 “Kosova e Re”
- Kroacia – 1
- Maqedonia – 1
- Mali i Zi – 1
- Serbia – 4
- Bosnja dhe Hercegovina – 8
- Rumania - 2
- Greqia - 1
- Turqia – 75



BROSHURA



FAKTET KRYESORE



PVETJET MË TË SHPESHTA



PARASHIKIMI I PËRDORIMIT TË THËNGJILLIT NË KOSOVË

Vazhdim i përdorimit të thëngjillit për prodhim të energjisë dhe ndërtimi i termocentralit “Kosova e Re” është nevojë dhe pjesë e një strategjie afatgjatë të përcaktuar nga Qeveria e Kosovës për të siguruar stabilitet dhe siguri të furnizimit. Kjo mundësohet nga eksploatimi i thëngjillit vendor, një nga rezervat më të mëdha në Evropë pas Gjermanisë dhe Polonisë. Kosova nuk ka nevojë ta importojë thëngjillin, ndryshe nga vendet tjera evropiane të cilat bazohen në energji të prodhuar nga thëngjilli. Kjo pasuri shtetërore i mundëson Kosovës ta projektojë të ardhmen energjetike dhe t’i përgjigjet kërkesës në rritje për energji elektrike. Kosova përdor rreth 8 milionë tonë thëngjill në vit për të vënë në funksion termocentralet ekzistuese. Ky nivel

pritet të mbetet i njëjtë edhe kur të futet në prodhim Termocentrali “Kosova e Re” në vitin 2023, pasi që parashihet të dekomisionohet Termocentrali “Kosova A”. Përdorimi i thëngjillit do të përgjysmohet në 4 milionë tonë në vit, kur “Kosova B” të dekomisionohet në vitin 2040.

Paralelisht me uljen dhe përfundimisht përjashtimin e thëngjillit si burim për prodhim të energjisë rreth vitit 2060, Kosova është e përkushtuar të zhvillojë kapacitetet nga burime e ripërtëritshme të energjisë dhe të mbulojë kërkesën e brendshme me energji.

Andaj, duhet të ceket se Termocentrali “Kosova e Re” nuk do ta rris kërkesën për eksploatim më të madh të thëngjillit sesa prodhimi aktual.



TERMOCENTRALI I RI ME STANDARDET MË TË REJA EVROPIANE

KOSOVA E RE ≥ 42,0% EFIÇIENCË

Termocentrali "Kosova e Re" do të dizajnohet dhe do të ndërtohet në kuadër Direktivës për Emetime Industriale (Industrial Emissions Directive - IED)¹ të BE. Energjia që do të prodhohet nga "Kosova e Re" do të emetojë në atmosferë shumë herë më pak krahasuar me termocentralet ekzistuese, "Kosova B" dhe sidomos "Kosova A". Pragu i efikasitetit të pararendur për "Kosova e Re" është plotësisht i harmonizuar me kërkesat e BE-së për Teknikat më të mira në Dispozicion (Best Available Techniques – BAT).

Direktiva e BE-së për Emetimet Industriale përçon një qasje të integruar, që merr parasysh teknikat më të mira në dispozicion, si dhe lejet për operim që ndërlidhen me njësinë në fjalë. Këto leje trajtojnë performancën e përgjithshme mjedisore të njësive gjeneruese, përfshirë edhe emetimet

në ajër, ujë, tokë; mbetjet e prodhuara; përdorimin e lëndës së parë; efikasitetin e energjisë; zhurmën; parandalimin e aksidenteve; dhe restaurimin e lokacionit pas mbylljes.

Njësia e re do të performojë me një standard ku efikasiteti është së paku 42% që përkthehet në ulje konsumit të tëngjillit, të ujit dhe rrjedhimisht uljes së emetimeve.

Pra, me dekomisionimin e termocentralit "Kosova A", rehabilitimin e termocentralit "Kosova B", si dhe me ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re", Republika e Kosovës bëhet prodhues i energjisë elektrike duke i përmbushur të gjitha kriteret që burojnë nga direktiva më e re e Bashkimit Evropian për emetimet industriale.

1. Direktiva për Emetime Industriale e Bashkimit Evropian
<http://ec.europa.eu/environment/industry/stationary/ied/legislation.htm>

DOKUMENTET E PROJEKTIT

Më shumë informata për Termocentralin "Kosova e Re" mund të gjeni në linqet më poshtë përmes dokumenteve si Marrëveshjet Komerciale, Broshura, Fakte Kryesore, Pyetje të Shpeshta, uebfaqja dhe rrjetet sociale.



- | | |
|---|---|
| Marrëveshja për Blerje të Energjisë | Marrëveshja e Largimit të Hirit dhe Gjipsit |
| Marrëveshja e Zbatimit | Marrëveshja për Furnizim me Linjit |
| Marrëveshja për Mbështetje të Sponsorit | Marrëveshja për Kyçje |
| Marrëveshja për Bartjen e Lokacionit | Marrëveshja për Furnizim me Ujë |

LINQET

- | |
|---|
| Ministria e Zhvillimit Ekonomik |
| Termocentrali "Kosova e Re" |
| Strategjia e Energjisë |

MEDIAT SOCIALE

- | |
|--------------------------|
| Facebook |
| Twitter |
| Youtube |

DOKUMENTET



BROSHURA



FAKTET KRYESORE



PYETJET MË TË SHPESHTA



QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Tel. 038 200 215 83
www.mzhe-ks.net

ADRESA:
QEVERIA E KOSOVËS
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK
SHESHI "ZAHIR PAJAZITI", NR.36
10000 PRISHTINË, REPUBLIKA E KOSOVËS